



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Dokumenti mbi Politikat #1

NTB-të në kontekst të CEFTA-së:
Rasti i Serbisë kundër Kosovës

Mbështetur nga:

Ky publikim është mbështetur nga projekti i BE-së 'Asistencë Teknike Zhvillimit të Mëtuqjeshëm të Politikës Tregtare të Kosovës'.

**EU Trade
Policy Project**

implemented by:

**Autorët:**

Zef Dedaj, *Zyrtar i lartë për Politikë Tregtare, MTI*
Merita Fetahu, *Analiste Tregtare, MTI*
Daniel Linotte, *Udhëheqës Ekipi, Projekti i BE-së për Politika Tregtare*

Mohim i përgjegjesisë:

Këtë publikim e ka nxjerrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e MTI-së dhe kurrsesi nuk i paraqet pikëpamjet e mbështetësit.

Publikuar nga:

Ministria e Tregtisë dhe
Industrisë

rr. Muharrem Fejza
p.n. Lagjja e Spitalit
10 000 Prishtina
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
HYRJE	4
1. HYRJE: PËRKUFIZIMI DHE TIPOLOGJIA E BARRIERAVE JO-TARIFORE	5
1.1 PËRKUFIZIMI I BARRIERAVE JO-TARIFORE	5
1.2 KLASIFIKIMI I BARRIERAVE JO-TARIFORE	6
2. MASAT TEKNIKE, SANITARE DHE FITO-SANITARE	7
2.1 REFERENCA NË OBT	7
2.2 TREGTIA E KOSOVËS ME SERBINË	8
2.3 RASTET ME SERBINË	8
3. MASAT JO-TEKNIKE	10
3.1 RREGULLAT E ORIGINËS	10
3.2 ÇËSHTJET E TRANZITIT	11
4. OPSIONET E POLITIKAVE	13
4.1 PESË OPSIONET	13
4.2 OPSIONET E POZICIONIMIT	15
KONKLuzionET	16
REFERENCAT	17
SHTOJCA 1: KLASIFIKIMI UNCTAD I MASAVE JO-TARIFORE	18
SHTOJCA 2: TË DHËNAT DHE SHKËMBIMET TREGT. TË KOSOVËS ME SERBINË	19



SHKURTESAT

CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
BE	Bashkimi European
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BDHBQT	Baza e të Dhënave mbi Barrierat e Qasjes në Treg
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NTB-të	Barrierat Jo-Tarifore
NTM-të	Masat Jo-Tarifore
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
ReO	Rregullat e Origjinës
SPS	Standardet Sanitare dhe Fito-Sanitare
TBT-të	Barrierat Teknike në Tregti
UNCTAD	Konferenca për Tregti dhe Zhvillim e Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

HYRJJE

Kosova po përballet me deficite të jashtme shumë të mëdha, veçanërisht në tregtinë e mallrave. Fakti që Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në rajon është shenjë e qartë e vështirësive me të cilat përballen kompanitë kosovare në tregtinë ndërkombëtare. Disa nga këto vështirësi kanë të bëjnë me barrierat tregtare. Në këtë drejtim, autoritetet serbe rregullisht po i përdorin barrierat në tregti tek produktet bujqësore dhe jo-bujqësore që eksportohen nga Kosova për në Serbi ose të cilat kalojnë nëpër territorin e Serbisë, si importe ose eksporte kosovare.

Barrierat e përdorura nga Serbia janë të natyrave të ndryshme: Barriera Jo-Tarifore, Barriera Teknike në Tregti dhe Standardet/Masat Sanitare dhe Fito-Sanitare. Përveç kësaj, vlen të përmendet se tranziti i produkteve kosovare nëpër Serbi po përballet edhe me pengesa administrative. Kështu, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, çështja e tranzitit u bë pengesë e madhe për disa kompani kosovare gjatë importimit nga vendet tjera, përfshirë vendet e BE-së, apo gjatë eksportimit. Deri në kohët e fundit edhe lëvizja e njerëzve është penguar dhe kundërshtuar nga Serbia.

Vlen të përmendet se këto çështje janë adresuar gjatë mbledhjeve të Nën-komitetit për Barrierat Teknike në Tregti (TBT) dhe Barrierat Jo-Tarifore (NTB), në CEFTA, madje edhe nga Komiteti i Përbashkët, i cili është niveli më i lartë për çështje të tilla në CEFTA. Janë ngritur çështje të ngjashme gjatë takimeve të përbashkëta, të organizuara nga Odat Ekonomike të Kosovës dhe Serbisë, por për fat të keq nuk është gjetur zgjidhje e përhershme dhe përveç kësaj, ka tendencë që me kohë rastet të përsëriten vazhdimisht.

Qeveria e Kosovës e percepton promovimin e eksporteve si politikë me prioritetin të lartë dhe në atë kontekst, CEFTA 2006 jep një kornizë të veçantë për përfundim të marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike me të gjitha vendet fqinje, mbi baza të barabarta, pa kurrfarë diskriminimi. Sot, në kuadër të CEFTA-së, Serbia përfaqëson gjithashtu një nga partnerët kryesor tregtar të Kosovës. Duke pasur parasysh këto të dhëna, duhet të pranojmë se barrierat e ngritura nga pala serbe ndaj mallrave kosovare mund të dëmtojnë seriozisht tregtinë dhe ekonominë e Kosovës. Pavarësisht këtyre kostove, Serbia vazhdon të vendos lloje të ndryshme të barrierave ndaj produkteve kosovare.

Në një kontekst aq të vështirë, anëtarët e CEFTA-s duhet të vazhdojnë të adresojnë pengesat dhe problemet tregtare me masa të veçanta që synojnë eliminimin e barrierave tregtare dhe rritjen e efikasitetit të politikave për shkurtimin e periudhës kohore nga momenti kur një entitet biznesi raporton një barrierë deri në momentin e zgjidhjes së çështjes.

Në këtë dokument i shtjellojmë NTB-të në kuadër të CEFTA-s, në veçanti rastin e tregtisë së Kosovës me dhe nëpër Serbi. Kështu, e bëjmë vlerësimin e NTB-ve të ngritura nga pala serbe, duke iu referuar Masave, Standardeve Sanitare dhe Fito-sanitare (SPS) dhe Barrierave tjera Teknike në Tregti (TBT-të). Gjithashtu i referohemi tranzitit të mallrave nëpër territorin e Serbisë. Ne e përfundojmë me ofrimin e alternativave të zgjedhura të politikave të cilat mund të ndihmojnë në adresimin e këtyre barrierave dhe ndikimeve të tyre.

Dokumenti bazohet në Bazën e të Dhënave për Barriera të Qasjes në Treg të drejtuar nga CEFTA për të paraqitur rastet të cilat kompanitë kosovare i kanë parashtruar deri më tani gjatë eksportimit në Serbi. Përmes kësaj baze të të dhënave, të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s kanë mundur të identifikojnë dhe adresojnë barrierat tregtare të vendosura për mallrat brenda rajonit të CEFTA-s.

Përveç kësaj, janë marrë parasysh disa nga çështjet / problemet e ngritura gjatë mbledhjeve të rregullta të Nën-grupeve Punuese për Politika Tregtare të MTI-së me kompani të ndryshme. Janë cilësuar edhe si shumë të dobishme mbledhjet ad-hoc me kompani të ndryshme, lidhur me rastet e NTB-ve, TBT-ve, SPS-ve, për mbledhje të informatave relevante të raportuara në këtë dokument.

Ky dokument pritet të kontribuoj në të kuptuarit e NTB-ve dhe implikimeve të tyre brenda CEFTA-së, duke u përqendruar në tregtinë midis Kosovës dhe Serbisë. Ai përbëhet nga katër pjesë kryesore: (1) përkufizimi dhe tipologjia e NTB-ve, (2) masat teknike si të tilla, (3) masat jo-teknike; dhe (4) opsionet e politikave.

1. HYRJE: PËRKUFIZIMET DHE TIPOLOGJIA E BARRIERAVE JO-TARIFORE

1.1 Përkufizimi i Barrierave Jo-Tarifore

Barrierat Jo-Tarifore (NTB-të) i referohen masave të politikave përveç tarifave të rëndomta doganore, të cilat potencialisht mund të kenë ndikim ekonomik në tregtinë e mallrave ndërkombëtare, duke i ndryshuar sasinë e tregtuara, ose çmimet, ose të dyja (për më shumë hollësi, shih UNCTAD, 2013). Me fjalë të tjera, siç theksojnë Deardorf dhe Stern (1997), NTB-të përmbajnë të gjitha masat përveç tarifave që kufizojnë ose ndryshe çrregullojnë shkëmbimet tregtare.

Vështirësia themelore në trajtimin e NTB-ve është se ato përcaktohen për atë që nuk janë e jo për atë që janë. Domethënë, NTB-të përfshijnë të gjitha barrierat në tregti të cilat nuk janë tarifa. Në të vërtetë ato janë edhe më të përgjithshme se kaq, pasi që termi shpesh përdoret

për të përfshirë ndërhyrjet me tregti siç janë subvencionet e eksportit që shërbejnë më tepër për të nxitur se sa për të penguar tregtinë dhe, për këtë arsye, ato në vetvete nuk janë "pengesa" në tregti. Pra, NTB-të përfshijnë politikat e mirënjohura të çrregullimit të tregtisë, siç janë kuotat e importit dhe ndalimet, masat mbrojtëse, si dhe kufizimet në eksportin vullnetar (KEV-ët).

Përveç kësaj, NTB-të mund të përfshijnë një bollëk potencialisht të pakufizuar të politikave, ndoshta që akoma nuk janë shpikur, të cilat ndryshojnë ose mund të ndryshojnë në mënyrë të tërthortë çmimet dhe / ose sasisë e të ashtuquajturave mallra të tregtueshme.

Sipas informatave të marra nga ueb faqja e OBT-së, NTB-të përbëhen nga një grup krejtësisht tjetër i masave të politikave, të cilat mund të jenë individualisht aq të ndryshme nga njëra tjetra, po aq sa janë edhe kolektivisht të ndryshme nga tarifat e importit.

Shembujt e NTB-së janë: Rregullat e Origjinës, Standardet Sanitare dhe Fito-Sanitare, masat ose Kushtet, Barrierat Teknike në Tregti, Licencat e Importit, Licencat Kufizuese, praktikat korruptuese dhe/ose procedurat e gjata doganore dhe kërkesat shtesë për dokumentet tregtare si licenca dhe certifikata të ndryshme.

1.2 Klasifikimi i Barrierave Jo-Tarifore

Siç u paraqitet në Shtojcën 1, Barrierat Jo-tarifore mund të kategorizohen në tre kapituj kryesor, përkatësisht: Masat Sanitare dhe Fito-sanitare, Barrierat Teknike në Tregti, Inspektimi Para-dërgesës dhe formalitetet tjera (UNCTAD, 2013).

Masat Sanitare dhe Fito-sanitare përfshijnë rregulloret dhe kufizimet për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve. Ajo mbledh masat siç janë kufizimet për substanca të veçanta dhe për të siguruar sigurinë e ushqimit, si dhe ato për parandalimin e përhapjes së sëmundjes ose dëmtuesve. Ato përfshijnë edhe të gjitha masat e vlerësimit të konformitetit që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit, siç janë certifikimi, testimi dhe inspektimit dhe karantina.

Barrierat Teknike në Tregti i adresojnë të gjitha rregulloret tjera teknike dhe standardet. Kjo i referohet masave siç janë: etiketimi, standardet për specifikimet teknike dhe kërkesat e cilësisë dhe masat tjera që e mbrojnë mjedisin. Si në rastin e masave SPS, TBT-të përfshijnë edhe të gjitha procedurat e vlerësimit të konformitetit të cilat vendosen për një qëllim jo-tregtar. Masat SPS dhe TBT-të kanë ndikim të rëndësishëm ekonomik në tregtinë ndërkombëtare. Inspektimi Para-dërgesave dhe formalitetet tjera janë masa të cilat kërkojnë që importet të inspektohen nga një kompani private e mbikëqyrjes në vendin e origjinës së dërgesës, në vend të inspektimit vetëm në doganë të vendit importues.

NTB-të mbulohen brenda Marrëveshjes së CEFTA-së dhe është përgjegjësi e palëve kontraktuese që rregullisht të raportojnë ose njoftojnë mbi NTB-të.

RAPORTIMI I NTB-VE NË KUADËR TË CEFTA-SË

Shumë nga masat kufizuese të vendosura nga Serbia ndaj Kosovës janë futur në bazën e të Dhënave mbi Barrierat e Qasjes në Treg dhe nëse shikojmë në këtë Bazë të të Dhënave për njoftimin e rasteve, mund të shihet se Kosova kryesisht i ka parashtruar njoftimet si vend raportues dhe akoma është në pritje që çështjet e parashtruara të trajtohen plotësisht në mënyrë të drejtë, sidomos kur bëhet fjalë për rastet me Serbinë, qoftë nëse ato kanë të bëjnë me SPS, TBT ose çështjet e tranzitit.

Këtë e tutje, i përshkruajmë disa raste dhe natyrën e problemeve me të cilat përballen kompanitë kosovare gjatë eksportimit në Serbi, ose problemeve me transitin gjatë importimit në vendet e BE-së dhe kalimit nëpër territorin serb.

2. MASAT TEKNIKE, SANITARE DHE FITO-SANITARE

2.1 Referenca në OBT

Sipas Marrëveshjes së CEFTA-s, Neni 12 mbi masat SPS, "të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me zbatimin e masave sanitare dhe fito-sanitare, do të rregullohen me Marrëveshjen e OBT-së mbi Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fito-sanitare". Pas Marrëveshjes së OBT, "Palët bashkëpunojnë në fushën e masave sanitare dhe fito-sanitare, përfshirë çështjet veterinarë, me qëllim të zbatimit të rregulloreve përkatëse në mënyrë jo-diskriminuese. Secila palë, me kërkesë të Palës tjetër, ofron informata mbi masat sanitare dhe fito-sanitare". Pothuajse e njëjta vlen për TBT-të - Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me aplikimin e barrierave teknike në tregti do të rregullohen me Marrëveshjen e OBT-së mbi Barrierat Teknike në Tregti, përveç nëse parashikohet ndryshe në Nen. Palët marrin përsipër të identifikojnë dhe heqin barrierat e panevojshme ekzistuese teknike në tregti në kuadër të kuptimit të Marrëveshjes së OBT-së mbi Barrierat Teknike në Tregti. Ato bashkëpunojnë, në Komitetin e Përbashkët, ose në një komitet të veçantë për barrierat teknike në çështjet tregtare, për të lehtësuar dhe harmonizuar rregulloret teknike, standardet dhe procedurat e detyrueshme të vlerësimit të konformitetit me qëllim të heqjes së barrierave teknike në tregti."

Më shpesh, në kushte normale, masat SPS dhe TBT-të kanë për qëllim që të sigurojnë cilësi dhe garanci të sigurisë për produktet bujqësore dhe, si rrjedhojë, rritjen e besimit të konsumatorit. Por, nganjëherë ato mund të përdoren si barriera reale me qëllim të çrregullimit të tregtisë midis vendeve, siç po e bën Serbia *de facto* kundër eksportuesve kosovarë. Në këtë drejtim, kohët e fundit, produkteve agro-ushqimore të Kosovës nuk u lejohet të hyjnë në territorin e Serbisë, pa testim shtesë dhe të pajustificuar të SPS-ve.

2.2 Tregtia e Kosovës me Serbinë

Siç shihet nga të dhënat e raportuara në Shtojcën 2, Kosova tregon deficit shumë të lartë tregtar me Serbinë. Një gjendje e tillë e pasqyron pjesërisht faktin se Kosova nuk vendos barriera të veçanta tregtare ndaj produkteve serbe, gjë e cila rezulton në akumulimin e mosbalancimit të qëndrueshëm në llogari të Kosovës. Lidhur me këtë, lloje të ndryshme të barrierave rregullisht ose sistematikisht përdoren kundër Kosovës për produktet bujqësore dhe jo-bujqësore. Duke marrë parasysh dëshmitë, mund të thuhet se një pjesë e deficitit tregtar të Kosovës përballë Serbisë duket se shpjegohet me vendosjen e llojeve të ndryshme të barrierave siç janë: NTB-të, TBT-të dhe SPS, përfshirë çështjet e lidhura me tranzit, kundër produkteve të Kosovës, në veçanti atyre agro-ushqimore.

Në fakt, kur shqyrtohet tregtia e produkteve bujqësore dhe jo-bujqësore në mes të Kosovës dhe Serbisë, janë vetëm disa produkte të cilat Kosova mund t'i eksportojë në Serbi dhe një gamë e gjerë e produkteve importohet nga Serbia – produkte për të cilat Kosova nuk aplikon barrierë të panevojshme kufizuese.

Siç mund të shihet, për shumë pak produkte të cilat Kosova i eksporton në Serbi, dogana serbe, ndonjëherë ndjek udhëzimet e organeve tjera shtetërore, siç është për shembull Inspeksioni i Ushqimit dhe Veterinarisë, vendos lloje të ndryshme të barrierave për eksportuesit kosovar, krahasuar me sasinë e madhe të produkteve që kompanitë serbe i eksportojnë në Kosovë dhe për të cilat autoritetet kosovare nuk shqiptojnë masa kufizuese.

2.3 Rastet me Serbinë

Sa i përket Serbisë, shumë procedura dhe kërkesa të testimit, dhe proceset e gjata të inspektimeve, kanë pasur ndikim të madh negativ në firmat bujqësore kosovare. Prandaj, mjaft shpesh, kompanitë kosovare janë ballafaquar me pengesa të papritura të ngritura nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Serbisë, duke rritur kostot e kalimit të kufirit në aspektin e kohës së humbur dhe të hollave, gjë e cila i bën produktet e Kosovës shumë më pak konkurruese në tregjet serbe. Më konkretisht, në vitin 2014, një kompani tregtare kosovare, duke eksportuar në Serbi disa materiale të papërpunuara (përkatësisht bërsitë dhe mbetje të tjera të forta, nëse janë apo jo të bluara apo në formë të sferave, të fituara nga

ekstraktimi i farave të lulediellit) është përballur me kërkesa të reja të vendosura nga autoritetet serbe:

Janë kërkuar dy analiza shtesë për çdo dërgesë (gjë e cila çoi në shpenzime shtesë sa i përket parave dhe kohës për eksportuesit kosovar).

Për shkak të këtyre pengesave mund të kenë humbur mijëra euro.

Sa i përket vendeve në zhvillim, për prodhuesit e mëdhenj, nuk ka problem për të qenë në pajtueshmëri me shumicën e kërkesave SPS dhe TBT, ndërsa për prodhuesit e vegjël dhe të mesëm, në vendet e tranzicionit dhe atyre në zhvillim, siç është Kosova dhe anëtarët tjerë të CEFTA-së, kjo është më e ndërlikuar dhe përmbushja e të gjitha standardeve SPS dhe tejkalimi i TBT-ve kërkojnë më shumë kohë dhe mjete, të cilën gjë nuk mund ta përballojnë me lehtësi shumë firma. Lidhur me këtë, mos-njohja e certifikatave ekzistuese për cilësinë e produktit të lëshuara nga organet zyrtare (gjegj. certifikatat sanitare, fito-sanitare dhe veterinare për produkte agro-ushqimore) mund të bëhen pengesë serioze në tregti. Kjo është çështje problematike e shkaktuar nga Serbia kundër produkteve kosovare.

Një çështje tjetër e ngjashme për masat SPS dhe TBT-të me të cilën është përballur kohëve të fundit një kompani eksportuese kosovare janë kërkesat e reja të shqiptuara nga autoritetet serbe për eksportimin në tregun serb:

Në pikën kufitare "Dheu i Bardhë", dërgesa e kompanisë nuk ka mundur të inspektohet për shkak të mungesës së inspektorit fito-sanitar dhe pas pritjes tri ditore, kamioni i kompanisë në fund është detyruar të kthehej dhe të shfrytëzoj pikë kalimin kufitar në Merdare për eksportimin e produkteve të saj (transporti i mëtejme ka krijuar shpenzime shtesë prej 220 €). Me të arritur dërgesa e kompanisë në Merdare, edhe pse Kompania kosovare i kishte përfunduar të gjitha analizat e nevojshme të testimit në Kosovë, inspektorët fito-sanitar serb kërkuan që analizat e njëjta të kryhen përsëri nga institucionet serbe.

Kositja e një kontrolli të tillë është shumë e lartë, me një produkt i cili kushton rreth 145€ dhe kompania donte të eksportonte 13 lloje të produkteve, që në total kushtonte 1,885€. Analizat shtesë janë kërkuar për çdo dërgesë dhe për ta bërë këtë, u deshën rreth 10 ditë dhe gjatë kohës së humbur të pritjes në kufi, kompania është përballur me shpenzime shtesë për çdo kamion. Edhe pse u arrit një marrëveshje ndërmjet eksportuesit kosovar dhe importuesit serb, në këtë rast Kompania kosovare është përballur me masa të pajustificueshme SPS.

Raste tjera tregojnë gjithashtu se Serbia rregullisht ka vendosur masa të pajustificueshme.

Në përgjithësi, ajo që ka rëndësi është se Serbia po tregon mungesë të qartë të qëndrueshmërisë, për shkak se kërkesat që duhet të përmbushen nga produktet e Kosovës ndërrojnë me kohë, gjë e cila bie ndesh me rregullat e CEFTA 2006.

ADRESIMI I KUFIZIME TË SERBISË

Për këto raste, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë u takua me anëtarët tjerë në nivel teknik brenda CEFTA-së, në Komitetin dhe Nën-Komitetet përkatëse, si dhe në baza bilaterale me përfaqësuesit e Serbisë për ta zgjidhur problemin.

Edhe pse ky problem u zgjidh, nga përvoja nuk mund të konsiderojmë se pengesa të ngjashme nuk do të përsëriten. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë konsideron se kërkesat shtesë paraqesin pengesa të reja – që konsiderohen si NTB, të cilat krijojnë shpenzime, si për eksportuesit kosovar, ashtu edhe për importuesit serb.

Përveç kësaj, rastet e raportuara bien ndesh me parimet e CEFTA-së mbi heqjen e NTB-ve dhe TBT-ve. Me fjalë të tjera, autoritetet serbe nuk duan të përmbushin zotimet e tyre ndërkombëtare.

3. MASAT JO-TEKNIKE

3.1 Rregullat e origjinës

Sipas Marrëveshjes së CEFTA-së, palët thjeshtësojnë dhe lehtësojnë procedurat doganore dhe reduktojnë, sa më shumë që të jetë e mundur, formalitetet e vendosura për tregti. Ata e zgjidhin çdo vështirësi që del nga zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me Nenin 42.¹

Kështu, rregullat e origjinës në përgjithësi konsiderohen si një nga kriteret kryesore të cilat përcaktojnë vendin apo territorin e origjinës së produktit, dhe më shpesh detyrimet dhe kufizimet e importit varen nga origjina e importeve. Masat e kësaj natyre i ka ndërmarrë Serbia ndaj prodhuesve kosovarë. Nga pikëpamja ekonomike, masat e tilla patën efekt të drejtpërdrejt negativ në tregti. Rasti i zgjedhur mbulon masat, përfshirë edhe ato të cilat lidhen direkt me rregullat e origjinës, të cilat janë aplikuar në mënyrë të pajustificueshme ndaj eksportuesve kosovarë.

Një kompani tregtare kosovare gjatë eksportimit në tregun e Serbisë të disa produkteve bujqësore, është përballur me kushte të reja të vendosura nga autoritetet serbe:

¹ Marrëveshja e CEFTA-së, kapitulli V, Neni 1 mbi Rregullat e Origjinës

Kështu, nga eksportuesi kosovar është kërkuar të sjellin të ashtuquajturën certifikatë 1 EUR me "vulë të APKM" në vend të vulës kombëtare kosovare.

Për shkak të faktit se dokumentet zyrtare të Kosovës ende nuk pranohen plotësisht nga autoritetet serbe për shkak të mos-njohjes së pavarësisë së Kosovës, Kompanitë kosovare përballen me pengesa të papritura të ngritura nga dogana e Serbisë, duke rritur shpenzimet e kalimit të kufirit në aspektin e kohës së humbur dhe parave, gjë që i bëjnë produktet e Kosovës më pak konkurruese në tregjet serbe.

3.2 Çështjet e tranzitit

Sipas marrëveshjes së CEFTA-së, njëri nga objektivat e Nenit 1 është: "heqja e barrierave në dhe çrregullimi i tregtisë dhe lehtësimi i lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve në tranzit midis territoreve të Palëve"².

Përveç masave kufizuese tregtare siç janë Barrierat Teknike në Tregti dhe ato SPS të cilat janë vendosur për eksportet e Kosovës, ka edhe pengesa që janë ngritur kundër tranzitit të dërgesave nga/në Kosovë nëpër territorin serb.

Që nga viti 2008, çështja e tranzitit nëpër Serbi është bërë pengesë e rëndësishme për kompanitë kosovare. Ekzistojnë shumë kompani tregtare kosovare të cilat importojnë nga vendet e BE-së produkte të ndryshme dhe lëndë të parë dhe të cilët e posedojnë tërë dokumentacionin e nevojshëm. Edhe pse kompanitë kosovare i posedojnë të gjitha dokumentet e nevojshme, në kufirin serb mund të paraqitet problemi i natyrës së tranzitit. Autoritetet serbe kanë kërkuar nga kompanitë kosovare të sigurojnë një dokument i cili nuk është kërkuar më parë dhe kjo nuk hyn në natyrën e tranzitit si i tillë. Prandaj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë ankesa nga kompanitë kosovare të cilat deklarojnë se autoritetet serbe kanë kërkuar nga ata të marrin një certifikatë e cila duhet të jetë e lëshuar nga UNMIK-u, institucion i cili nuk është në pozitë të lëshoj një dokument të tillë. Vlen të ceket se për të kaluar nëpër territorin serb, shkresa e kërkuar është shndërruar në licencë importi, certifikatë ose dokument të cilin duhet ta lëshoj Ministria serbe e Bujqësisë. Mirëpo, duke pasur parasysh se kompanitë kosovare nuk kanë mundur të marrin certifikatë të tillë dhe ky veprim nuk është në përputhje me vendimet e CEFTA-së, kushtet e tranzitit paraqesin çështje prioritare për shqyrtim në CEFTA.

Çështjet e lartpërmendura i kanë shtyrë kompanitë kosovare të mendojnë për rrugë tjera alternative për t'i ikur kalimit nëpër Serbi. Kjo ka krijuar shpenzime shtesë në para dhe

² Marrëveshja e CEFTA-së, Neni 1.

kohë. Përveç kësaj, kjo ka ndikuar edhe në produktet tona, të cilat u shtrenjtuan dhe janë më pak konkurruese në rajon.

Siç u përmend më lartë, janë përdorur masa të ndryshme të pajustificueshme në kontekst të tranzitit ndaj importuesve kosovar dhe një rast i tillë ka ndodhur në fillim të vitit 2015, kur janë vendosur masat për SPS.

Kështu, një kompani kosovare, gjatë importimit të lëndës së parë nga Lituania (përkatësisht dheut që mund të përdoret për kultivimin e bimëve), është ndaluar në pikën kufitare "Horgos" në territorin e Serbisë; problemi ishte se certifikata fito-sanitare e cila është lëshuar nga agjenci përkatëse e ushqimit dhe veterinarisë të Lituaniës nuk njihet si i ligjshme nga autoritetet serbe në kufi për shkak se vendi i destinimit u emërua "Republika e Kosovës". Si pasojë, kamioni u bllokua në kufi dhe tranziti nuk u lejua për një kohë. Më pas, për të adresuar çështjen dhe për të gjetur një zgjidhje, MTI ka kontaktuar pikën kontaktin serb të CEFTA-së, ku u kërkua që të lejohet tranziti, sepse në këtë rast, Kosova është vendi importues, jo Serbia, dhe, përveç kësaj, veprimet e iniciuara nga autoritetet serbe nuk janë në përputhje me rregullat dhe praktikën e CEFTA-s.

Pra, siç u shpjegua më lart, në këtë rast, Serbia ka vendosur barriera të cilat bien ndesh me rregullat e CEFTA-s. Së pari, ata kanë kërkuar një certifikatë sanitare, dhe praktika për kërkim të dokumenteve të panevojshme shtesë për tranzit nuk mund të gjendet në vendet tjera të CEFTA-s. Së dyti, ata nuk e njohin certifikatën e cila ishte lëshuar nga autoritetet lituaneze vetëm për shkak se në certifikatë shkruante "Republika e Kosovës" dhe ajo nuk mund të ndryshohet nga autoritetet lituaneze, pasi që sistemi i BE-së e njeh vendin si Republikë e Kosovës.

PROCEDIMI I RASTEVE

Në ndërkohë, rasti është futur në Bazën e të Dhënave për Barrierat e Qasjes në Treg me Kosovën si vend raportues; prandaj, sekretariati i CEFTA-së ishte njoftuar menjëherë dhe rasti më pas automatikisht i është dërguar Serbisë, si vend i cili aplikon masën, duke i obliguar autoritetet serbe të japin përgjigje ose shpjegim mbi masat.

Pastaj, kompania ka raportuar se pas pritjes një ditë e gjysmë në kufi, përfundimisht u lejua tranziti, por me kosto shtesë në para dhe kohë.

Përveç kësaj, është edhe një rast i një natyrë më tepër të përhershme që ndikon në tranzit, përkatësisht mungesa e inspektorëve sanitarë, që veprojnë në pikën kufitare Verska Cuka.

Një kompani kosovare ishte përpjekur të importonte produkte agro-ushqimore nga Bullgaria nëpër këtë vend kalim kufitar (përkatësisht bërsitë dhe mbetje tjera të forta). Mirëpo, duke e ditur mungesën e inspektorëve kufitar, kompania përfundimisht është detyruar të përdor rrugë tjera alternative, gjë e cila ka krijuar shpenzime shtesë në kohë dhe para. Përveç kësaj, duhet cekur se përpos rastit të raportuar, ka edhe shembuj tjerë me probleme të tranzitit me Serbinë. Në këto kontekste, duhet gjetur rrugë alternative për t'i ikur kalimit nëpër Serbi.

Për më tepër, ky lloj i praktikës nuk mund të justifikohet juridikisht, duke pasur parasysh se në këtë rast Kosova është vendi importues, dhe jo anasjelltas; përveç kësaj, veprimet e iniciuara nga autoritetet serbe nuk përputhen fare me rregullat dhe praktikën e CEFTA-s, dhe ato nuk mund të gjenden në vendet tjera të rajonit. Në fund, vlen të përmendet se kjo çështje është adresuar në takimin e Komitetit të Posaçëm të Përbashkët, por nuk ka reagime pozitive deri tani nga pala serbe për të hequr barrierat përsëritur e natyrës tranzite.

Përveç kësaj, tranziti është adresuar në mbledhjet tjera; në Nën-komitetin për Barrierat Teknike në Tregti dhe Barrierat Jo-tarifore, si dhe gjatë takimeve bilaterale në mes të Odave Ekonomike të Kosovës dhe Serbisë.

4. OPSIONET E POLITIKAVE

Siç u shtjellua më lartë, Serbia po vendos rregullisht lloje të ndryshme të barrierave tregtare ndaj prodhuesve dhe tregtarëve kosovar.

Për të rritur tregtinë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duhet të bëhet përparim më i madh në reduktim, madje edhe heqje të NTB-ve.

Vlen të përsëritet dhe theksohet se ka prova të mëdha të mjaftueshme që tregojnë se Serbia nuk e trajton Kosovën si anëtarët tjerë të CEFTA-së - në fakt, ekziston një diskriminim mjaft sistematik ose anësi negative ndaj Kosovës.

4.1 Pesë opsionet

Ne ofrojmë pesë opsione të politikave për të adresuar NTB-të serbe ndaj Kosovës. Disa prej tyre tashmë janë zbatuar, pa zgjidhje përfundimtare dhe të përhershme. Duke marrë parasysh përfitimet dhe kostot e këtyre opsioneve, është e qartë se përfitimet kanë të bëjnë mbi të gjitha me lehtësimin e tregtisë mes dy vendeve - me fjalë të tjera, marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Serbisë do të mund të bëhen një lojë përmbledhëse pozitive, ku të gjitha palët mund të dalin fituese.

i. "Të mos bësh gjë"

Me këtë opsion, Kosova vetëm e lë Serbinë të vazhdoj të pengoj ose plotësisht t'i bllokoj produktet e Kosovës gjatë eksportimit dhe importimit ose tranzitit.

Kostoja e dukshme e një opsioni të tillë të politikës është se kompanitë e Kosovës do të jenë edhe më tej të dekurajuar për të tregtuar me të dhe përmes Serbisë; kjo do të ketë ndikime të mëdha negative në aktivitetet ekonomike në Kosovë dhe të kontribuoj në papunësi në vend.

"Të mos bësh gjë" gjithashtu e nxit Serbinë që të vazhdojë me mungesën e saj të qëllimshme të përputhshmërisë me zotimet e saj ndërkombëtare dhe praktikat e përbashkëta në Evropë.

ii. Zgjidhjet bilaterale

Ndoshta zgjidhjet e para më të mira sa i përket përfitimeve do të ishin kontaktet e drejtpërdrejta midis Kosovës dhe Serbisë.

Mirëpo, mund të supozohet se Serbia ende nuk është e gatshme të angazhohet përgjithmonë në një proces aq pozitiv për arsye të qarta politike, përkatësisht mosnjohjen e Kosovës si shtet sovran.

Kontaktet e tilla janë vënë në mes tjerash gjatë negociatave të vazhdueshme në CEFTA mbi çështje tjera (për shembull, liberalizimi i tregtisë së shërbimeve). Këto shkëmbime nuk ishin plotësisht përfundimtare dhe nuk ka mundur të arrihet një marrëveshje reale.

iii. Zgjidhjet në kuadër të CEFTA-së

Kosova është ende në pritje të reagimeve të duhura në kuadër të CEFTA-së. Megjithatë, Kosova mund të shtyjë më fuqishëm rastet e saj nëpër të gjitha proceset dhe procedurat formale të ofruara nga korniza e CEFTA-s për të adresuar pengesat tregtare dhe çështjet bilaterale. Në këtë drejtim, strukturat e CEFTA-së duhet të vazhdojnë të inkurajojnë të gjitha palët të përmbushin detyrimet e tyre për njoftim dhe të adresojnë menjëherë shqetësime e raportuara, menjëherë pasi të është bërë njoftimi mbi masat e reja rregullative.

Nëse nuk ka përgjigje të përshtatshme në përputhje me rregullat e CEFTA-s ose asnjë përgjigje brenda kornizës së CEFTA-së për një periudhe të arsyeshme kohore

(gjashtë muaj, apo një vit më së shumti?), çështja duhet ndoshta të shtyhet përpara, në nivel të BE-së.

iv. Ndërmjetësimi i BE-së

Duke supozuar se nuk mund të gjendet një zgjidhje në kuadër të CEFTA-s, Kosova mund të kërkojë nga BE të ndërmjetësoj dhe të mbështet negociatat me përfshirjen e tërthortë apo të drejtpërdrejtë të BE-së, duke këmbëngulur mbi të gjitha në faktin se anëtarësimi në CEFTA krijon zotime, detyrime dhe të drejta për të gjithë anëtarët, pa përjashtim.

Në realitet, nuk ka shumë gjasa që BE-ja t'i bëjë presion Serbisë. BE-ja duket se i favorizon dialogët e drejtpërdrejtë ndërmjet palëve pa shumë ndërhyrje nga jashtë - është edhe çështje e pronësisë nga palët dhe zotimet e vërteta në mes të palëve kryesore me interes për të shmangur shfrytëzimin e palëve të treta.

v. Masat e reciprocitetit/ndëshkuese

Nëse dialogët bilateral, zgjidhjet e CEFTA-së dhe ndërmjetësimi i BE-së nuk kanë sukses, Kosova mund të mbetet me një opSION shumë të pakëndshëm dhe të fundit, përkatësisht vendosjen e masave të ngjashme ose reciproke në mënyrë rreptësisht të ekuilibruar për të ulur importet që vijnë nga Serbia dhe, si rezultate të mundshme, të favorizohet zëvendësimi me produkte vendore ose importe nga vendet tjera.

Mirëpo, masat e tilla negative mund të shtyjnë Serbinë të reagoj ndaj produkteve dhe kompanive të Kosovës, që do të çonte në luftë të dëmshme dhe mjaft të padobishme tregtare midis dy palëve.

4.2 Opsionet e pozicionimit

Opsionet "i" dhe "v" shkaktojnë shpenzime të larta, për Kosovën (sidomos me opsionin "i") ose për të dyja palët në rastin e luftës së vërtetë tregtare – autoritetet kosovare dhe populli i Kosovës nuk e shohin këtë lloj rezultati si të mirë; prodhuesit dhe konsumatorët serb humbin gjithashtu edhe sa i përket profiteve dhe mirëqenies.

Opsioni "iv" në një mënyrë nuk pëlqehet për shkak se ai tregon se të dyja vendet mund vështirë të punojnë së bashku, pavarësisht se janë palë të marrëveshjes së njëjtë rajonale - CEFTA.

Prandaj, duhet të bëhet shumë e qartë se Kosova do të favorizoj gjithmonë dialogët e drejtpërdrejtë me Serbinë, para vendosjes së kufizimeve në importe të produkteve serbe.

Mbi të gjitha, autoritetet kosovare mendojnë se që të dy vendet duhet të bëjnë më të mirën e tyre dhe të respektojnë rekomandimet e bëra nga OECD, OBT dhe institucionet tjera kyçe për të promovuar lehtësimin dhe të ulin (madje edhe të heqin) të gjitha barrierat tregtare, në veçanti NBT-të. Kjo qasje, e cila është në përputhje me rregullat ndërkombëtare, i përgjigjet opsioneve "ii" dhe "iii".

KONKLuzionet

Barrierat Jo-Tarifore (NTB-të) janë mjete teknike të cilat shfrytëzohen për të parandaluar produkte të caktuara të hyjnë në një vend.

Siç u përmend në tekstin kryesor, janë përdorur shumë masa si NTB-të nga Serbia ndaj prodhuesve të Kosovës, duke filluar me masat sanitare dhe fito-sanitare, barrierat teknike në tregti dhe rregullat e origjinës.

Përveç kësaj, transiti nëpër Serbi përballet me barrierë shumë serioze, sidomos gjatë importimit nga vendet anëtare të BE-së nëpër territorin serb.

Kufizimet e vendosura nga Serbia ndaj produkteve kosovare duket se hyjnë më së shpeshti nën titullin masat Sanitare dhe Fito-sanitare. Mirëpo, Serbia po tregon mungesë mjaft serioze të qëndrueshmërisë, sepse kërkesat të cilat duhet t'i plotësojnë prodhuesit kosovar ndërrojnë me kohë dhe de facto ata janë të paparashikueshëm – gatishmëria e pakët dhe veprimet e tilla të paqëndrueshme bien ndesh me rregullat e CEFTA 2006.

Janë mbajtur disa takime brenda CEFTA-së dhe në mënyrë bilaterale si dhe me autoritetet serbe dhe përkundër të gjitha përpjekjeve nga pala kosovare, ende nuk është gjetur një zgjidhje e përhershme.

Nëse i hedhim një sy Bazës së të Dhënave mbi Barrierat e Qasjes në Treg të CEFTA-së tek njoftimet dhe rastet e pazgjidhura, mund të shihet se njoftimet e Kosovës ende nuk janë adresuar plotësisht.

REFERENCAT

Deardorff A. V. dhe Stern R. M. (1997), *Matja për Barrierat Jo-Tarifore*, Departamenti Ekonomik i OECD. Dokument Pune, Nr. 179.

Gashi P. dhe Linotte D., *Manuali mbi Treguesit e Tregtisë Ndërkombëtare* (Kapitulli 6: Barrierat Jo-Tarifore), Projekti për Politika Tregtare i BE, Prishtinë, 2015.

UNCTAD, *Masat Jo-Tarifore për tregti – Çështjet e politikave dhe ekonomike për vendet në zhvillim*, 2013.


Web faqet:

Marrëveshja e Evropës Qendrore mbi Tregtinë e Lirë - CEFTA 2006: www.cefta.int

Organizata Botërore e Tregtisë: www.wto.org

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik: www.oecd.org


SHTOJCA 1: KLASIFIKIMI I MASAVE JO-TARIFORE I UNCTAD-IT




18 Burimi: UNCTAD, *Masat jo-tarifore për tregti* – Çështjet e politikave dhe ekonomike për vendet në zhvillim, 2013.

SHTOJCA 2: TË DHËNAT E TREGTISË SË KOSOVËS DHE SHKËMBIMET ME SERBINË


TREGTIA E MALLRAVE TË KOSOVËS, 2005-2013 ('000 €)



TREGTIA E MALLRAVE E KOSOVËS ME CEFTA-NË, 2005-2013, ('000 €)



TREGTIA E KOSOVËS ME SERBINË, 2005-2013, ('000 €)



PARTNERËT KRYESOR TREGTAR TË KOSOVËS, 2013

Partnerët	Eksportet		Importet		Balanci Tregtar	
	Vlera ('000 €)	Pjesa (%)	Vlera ('000 €)	Pjesa (%)	Vlera ('000 €)	Pjesa (%)
CEFTA ¹						
Shqipëria	43,774	14.9	110,597	4.5	-66,823	3.1
Bosnja & Hercegovina	2,812	1.0	83,531	3.4	-80,719	3.7
Kroacia	2,594	0.9	73,331	3.0	-70,737	3.3
Maqedonia	26,139	8.9	185,020	7.6	-158,881	7.4
Mali i Zi	17,310	5.9	11,387	0.5	5,923	-0.3
Serbia	14,463	4.9	285,356	11.7	-270,893	12.6
BE	115,828	39.4	1,009,832	41.2	-894,004	41.5
Pjesa tjetër e botës	70,922	24.1	690,011	28.2	-619,089	28.7
Totali	293,842	100.0	2,449,064	100.0	-2,155,222	100.0

Veni re: ¹⁾ Moldova është përjashtuar; Duhet cekur se Kroacia është anëtarësuar në BE në korrik, 2013

Burimi: ASK, MTI

STRUKTURA E EKSPORTEVE TË KOSOVËS NË SERBI PRODUKTET USHQIMORE

Kategoritë kryesore të produkteve ushqimore që eksportohen në Serbi janë produktet bimore dhe ushqimet e gatshme dhe pijet.

PRODUKTET MË TË EKSPORTUARA NË KATEGORITË E PRODUKTEVE USHQIMORE, 2013

0810: Luleshtrydhet, mjedrat, manaferrat, rrushi i zi, i bardhë dhe i kuq logan, kullumbritë dhe fruta tjera të freskëta të ngrënshme (përveç arrave, bananeve, hurmave, fiqve, ananaseve, avokadove, guavave, mangove, mangostinëve, "papajave", frutave agrume, rrushit, pjeprave,

2204: Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi, pjesërisht i fermentuar dhe me forcë faktike të alkoolit prej > 0,5% vëll ose musht rrushi me alkool të shtuar me forcë faktike të alkoolit prej > 0,5% vëll

2202: Ujërat, përfsh. ujërat minerale dhe ujërat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëltuese apo aromatizues, dhe pijet tjera jo-alkoolike (përveç lëngut të frutave ose perimeve dhe qumështi)

2306: Bërsitë dhe mbetje të tjera të forta, nëse janë apo jo të bluara apo në formë të sferave, të fituara nga ekstraktimi i yndyrave ose vajrave vegjetale (përveç, nga vaji i sojës dhe vaji i kikirikut)

0709: Zarzavate tjera, të freskëta apo të ftohta (përveç patateve, domateve, zarzavateve djegëse, kolëza e ngrënshme, marula "Lactuca sativa" dhe çikore "Cichorium spp.", karotat, rrepanët, sallatë panxhari, rrepanët e zinj, zhardhok selinoje, rrepë të tjera dhe rrënjë të tjera të ngjashme të ngrënshme, trangulli

GRUPI I PRODUKTEVE JO-USHQIMORE INDUSTRIALE

Eksportet e Kosovës në këto kategori të mallrave përfaqësojnë 80 përqind të eksporteve të përgjithshme.

PRODUKTET MË TË EKSPORTUARA NË KATEGORITË E PRODUKTEVE JO-USHQIMORE, 2013

2523: Çimento, përf. klinkera çimentoje, nëse janë apo jo të ngjyrosur

8548: Mbetje dhe mbeturina të qelizave primare, baterive primare dhe akumulatorëve primar; qelizat primare të harxhuara, bateritë primare të harxhuara dhe akumulatorët elektrik të harxhuar; pjesët elektrike të makinerive apo aparaturave tjera, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër në kapitullin 85

7210: Produkte petëzimi të sheshtë prej gize apo çeliku jo të lidhur, të një gjerësie prej 600 m, të petëzuara në të nxehtë ose të petëzuara në të ftohtë "të reduktuar në të ftohtë", të mbuluar, pllakëzuar ose mvëshur

7306: Tuba, tubacione dhe profile të zgavruara (psh, me tegele saldimi të hapura apo të salduara, të percinuara apo të mbyllura" në mënyrë të ngjashme), prej gize dhe çeliku (përv. : prej gize të derdhur, tubat dhe tubacionet pa tegela dhe tubat të cilat kanë ndërprerje të brendshme dhe jashtme cirkulare dhe diametër të jashtëm prej > 406

7404: Mbetje dhe mbeturina të bakrit (përv. lingotave ose formave tjera të papërpunuara, prej mbetjeve dhe mbeturinave sërish të shkriira të bakrit, hirit dhe mbetjeve që përmbajnë bakër dhe mbetjet dhe mbeturinat e qelizave primare, baterive primare dhe akumulatorëve elektrik)
